



## Përmbledhje N°2

### Përzgjedhja e Personave për Intervistim në Kontekstin e Monitorimit të Parandalimit në Paraburgim

Që me themelimin e saj në vitin 1977, Shoqata e Parandalimit të Torturës (SHPT)ka promovuar një monitorim të rregullt dhe të pavarur të vendeve të paraburgimit si një mjet efektiv për parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimeve në paraburgim. Përmbledhjet e këtij Vargu të ri Përmbledhjesh mbi Monitorimin e Paraburgimit e bën analizën pioniere-kërkimore të SHPT-së si dhe praktikat më të mira të homologëve, të disponueshme për praktikuesit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në të gjithë botën. Qëllimi është të plotësojë dhe të japë një vlerësim më të detajuar të aspekteve që prezantohen në publikim e SHPT-së, *Monitorimi i vendeve të Paraburgimit: nje Guidë Praktike*

Reagimet, komentet apo sugjerimet mbi përmbajtjen e këtij Vargu Përmbledhjesh janë të mirëpritura dhe të dërgohen në adresën: [apt@apt.ch](mailto:apt@apt.ch).

## Përzgjedhja e Personave për Intervistim në Kontekstin e Monitorimit të Parandalimit të Paraburgimit

### 1. Si ta përdorim këtë përmbledhje

Ky dokument është hartuar të përdoret nga çdo organizatë që kryen apo planifikon të kryejë vizita në vendet e paraburgimit me qëllim parandalimin e torturës apo keqtrajtime të tjera. Ndërsa hartohet apo modifikohet një strategji monitorimi në tërësi ajo duhet të aplikohet ose duhet të informohet strategjia intervistuese përpara kryerjes së një vizite specifike. Strategjia fokusohet në përzgjedhjen e personave të privuar nga liria të cilët do të intervistohen. Si gjithmonë, ajo nuk jep një skemë por pak a shumë prezanton një varg opsionesh dhe çështjesh që organizmat monitorues të mund ti konsiderojnë në mënyrë që të përmirësojnë punën e tyre. Si orjntim se si të bëhet një intervistë shikoni publikimin e SHPT-së *Monitorimi i Vendeve të Paraburgimit: Një Orjentues Praktik (Monitoring Places of Detention: A Practical Guide)*.

### 2. Shqyrtimet fillestare

Intervistat private individuale me personat e privuar nga liria përbëjnë një pjesë thelbësore të vizitave monitoruese parandaluese. Ato të sigurojnë një informacion të drejtë për drejtë nga brenda dhe i mundësojnë mbajtësit të informacionit të shprehi edhe eksperiencën e tij. Ato theksojnë pjesë thelbësore që monitoruesit analitikë kërkojnë t'i bashkojnë bashkë të cilat të çojnë drejt identifikimit dhe të kuptuarit të atyre mosarritjeve sistematike që kanë impakt në gëzimin e të drejtave të njeriut në paraburgim.

Për një monitorim parandalues efektiv, duhet të intervistohen një numër i konsiderueshëm të paraburgosurish. Disa organizata monitoruese mendojnë se me intervistimin e 5%, 10% apo 20% të personave të paraburgosur në çdo vend paraburgimi mund të kesh një pasqyrim të mjaftueshëm. Kjo nuk mund të jetë e thjeshtë. Në shumë raste, qindra apo edhe mijëra persona mund të jenë mbajtur të gjithë në një vend të vetëm. Si rezultat, monitoruesve ju duhet të marrin vendime komplekse në mënyrë që të rrisin burimet e limituara njerëzore, materiale dhe kohore. Lidhur me intervistimin, gjithësesi është e nevojshme të jetë strategjik.

Është e rëndësishme të konsiderohet ndjekja e çështjeve me një politikë më të gjërë, përpara se t'i ktheheni strategjive specifike të përzgjedhjes.

#### ***Numri i personave në skuadër***

Brenda burimeve të organizatës së monitorimit dhe në përputhje me masen e vendit të paraburgimit që do të vizitohet, rritja e numrit të anëtarëve të skuadrës së monitorimit është e rëndësishme. Kjo i ndihmon ata të ndahen në skuadra të vogla dhe të punojnë paralel. Në këtë mënyrë mund të kryhen më shumë intervista brenda një periudhe kohe të dhënë.

#### ***Intervistim Individual ose në Palë***

Shumë organizata monitoruese preferojnë të kenë dy monitorues që të kryejnë çdo intervistë, njëri që drejton intervistën dhe tjetri që merr shënime. Kjo ka një avantazh të qartë. Megjithatë organizatat e tjera i lejojnë monitoruesit e tyre të intervistojnë vetëm nëse ata kanë eksperiencën e duhur. Kjo mundëson bërjen e më shumë intervistave në të njëjtën hapësirë kohore. Kjo gjithashtu do të mund të ishte më pak kërcënuese për të intervistuarin dhe kontribuon për një diskutim më të hapur. Megjithatë, kjo ka

disavantazhet e veta ne kuptimin e qëndrueshmërisë, të qenit e plotë, objektivitetit dhe sigurisë.

### ***Kohëzgjatja e Vizitës***

Mundësia e zgjatjes së kohës së vizites monitoruese duhet gjithashtu të konsiderohet. Kjo do të jepte më shumë kohë për intervistën dhe aspektet e tjera të vizitës. Në rastin e vizitave të thella, ku të gjitha aspektet e paraburgimit ekzaminohen tërësisht, disa institucione apo organizata kryejnë vizita deri katër ditore në qendrat e mëdha të paraburgimit. Inspektive të tilla alternohen me vizita të shkurtëra, të fokusuar në ndjekjen e gjetjeve.

### ***Shpeshtësia e Vizitave***

Një tjetër alternativë është kryerja e një vargu vizitash më të shkurtra dhe më të rregullta. Kjo bëhet më lehtë kur qendra në fjalë është pranë. Në rrethana të tilla, skuadra monitoruese mund të zgjedhë një apo disa pjesë të ndryshme të një ambjenti paraburgimi për ta vizituar, apo përzgjedh një temë specifike për çdo vizitë dhe në këtë mënyrë e monitoron ambjentin e paraburgimit tërësisht ose në mënyrë progresive. Kryerja e vizitave më të shpeshta pa asnjë axhendë njoftimi, do të çonte në shtimin e avantazheve dhe mund të inkurajojë një vëmendje të qëndrueshme të autoriteteve ndaj kushteve për të drejtat e njeriut. Për më tepër, vizitat e rregullta sigurojnë gjithashtu një mundësi të mirë për ndërtimin e marrëdhënieve dhe ndjekjen e tyre me autoritetet qendrore, personelin dhe personat e privuar nga liria e tyre.

### ***Informacioni Paraprak***

Rëndësia e parapërgatitjes efektive dhe e aksesimit të informacionit të duhur përpara bërjes së vizitës nuk mund të mos theksohet. Marrja e listave të personave në qendër dhe vendqëndrimi i tyre, plotësimi i listave me informacion hierarkik, njohja e sistemeve të klasifikimit dhe të ndarjeve, një hartë e vendodhjes dhe të dhëna të tjera si këto i mundësojnë skuadrës monitoruese të përzgjedhë në mënyrë më strategjike personat që do të intervistojë dhe të rrisë përdorimin e burimeve të disponueshme.

## **3. Metodologjitë Plotësuese për Intervistat Private**

Monitorimi për parandalimin e paraburgimit fokusohet ne identifikimin dhe analizimin e faktorëve që çojnë apo nuk parandalojnë torturën, keqtrajtimet e tjera apo mosrespektime të tjera të dinjitetit njerëzor në paraburgim. Monitorimi përqipet në mënyrë sistematike të zbusë apo eliminojë këta faktorë rrisht. Në këtë kontekst, intervistimi privat me të paraburgosurit duhet të kombinohet me informacionet e tjera të mbledhura dhe analizat ku përfshihen vëzhgimet e monitoruesve; rishikimi i dokumentacionit dhe regjistrave; intervistat me autoritetet; dhe analizat e ligjeve, institucioneve, politikave dhe procedurave. Mundësitë e mëposhtme mund të konsiderohen gjithashtu si ndihmuese drejt synimit për intervista më të mira.

### ***Pyetësi paraprak***

Disa organizata dhe institucione monitoruese administrojnë një pyetësor në qendrat e paraburgimit përpara kryerjes së vizitës së paralajmëruar. Pyetësi shpërndahet dhe më pas mbledhet nga një numër përfaqësuesish nga personat e paraburgosur. Pyetësi ka lidhje me eksperiencat dhe perceptimet e tyre individuale. Ai ndihmon në par-identifikimin e temave apo atyre pjesëve të paraburgimit ku do të kryhet vizita e mëvonëshme e në këtë mënyrë redukton numrin e çështjeve që do të trajtohen në intervistat private. Ekzaktësia e administrimit të këtij procesi prezanton sfidat që ka, përfshirë çështjet e analfabetizimit, respektimin e anonimitetit si dhe punës që kërkohet për përpunimin e informacionit. Megjithatë, ai përfaqëson një mjet që mund të integrohet

suksesshëm në metodologjinë e përgjithshme në kontekste të caktuara, veçanërisht në lidhje me qendrat e vogla apo të mesme.

### **Para-Vizita**

Një alternativë e pyetësorit para-vizitë është vizita paraprake. Kjo mund të kryehet si një tur nëpër vendqëndrime disa ditë apo javë përpara vizitës kryesore monitoruese në mënyrë që të para krijohet një përshtypje mbi situatën dhe të vendoset për strategjinë. Ky opsion ka avantazh se nuk kërkon prezencën e gjithë skuadrës monitoruese që në fillim, duke patur parasysh që qëllimi nuk është kryerja me thellësi e monitorimit. Për më tepër, takimi prezantues me drejtorin apo komandantin e qendrës mund të bëhet në një fazë më të hershme. Kjo gjë do të vendoste urat dhe do të kursente kohë kur të ishte prezente e gjithë skuadra. Në rrethana të tjera, para-vizita do të krijonte një mundësi për vlerësimin e shpejtë të risqeve potenciale për të paraburgosurit si rrjedhojë e monitorimit. Ndërsa do të ishte e dobishme të lajmërohej para-vizita, monitoruesit mund ta vendosin vetë nëse do të informojnë apo jo autoritetet për datën e saktë të vizitës kryesore.

### **Intervistat në Grup**

Organizimi i hershëm i intervistave në grup do të ishte një mënyrë e dobishme gjatë vizitës monitoruese për mbledhjen e informacionit të përgjithshëm mbi situatën dhe funksionimin e qendrës. Kjo do të reduktonte numrin e çështjeve që do të mbulohen në intervistat private por nuk do t'i zëvendësonte ato. Do të ishte gjithashtu i vetmi opsion, kur trupi monitorues shikon se është absolutisht e pamundur bërja e intervistave private. Shqyrtimi i një liste të plotë çështjesh me këto grupe në fillim të vizitës, do të shërbente si një minute-e-parë e dobishme për "leximin e temperaturës" për identifikimin e temave specifike, sistemeve, incidenteve apo personave për ndjekjen më nga afër. Duhet bërë kujdes me çështjet sensitive sikurse janë kryerja e një krimi apo pretendimi që të jetë kryer ky krim nga të paraburgosurit, dhuna apo kërcënimet ndër-personale apo dhuna seksuale, edhe pse nuk ka rregulla të fortë dhe të shpejtë. Rrezikshmëria për informatorët duhet gjithashtu të merret parasysh. Për më tepër, të njejta çështje të konfidencialitetit, të pranimit apo mospranimit për pjesëmarrje duhet të theksohen njësoj si në intervistat individuale.

## **4. Strategjitë e Përzgjedhjes së Personave për intervistat Private**

Objektivi kryesor në zhvillimin e një strategjie intervistimi për një vizitë të përgjithshme parandaluese, është të sigurohet se informacioni i mbledhur do të përfaqësonte kushtet e përgjithshme dhe ndërkohë do të pasqyronte situatat e ndeshura nga grupe apo individë të veçantë dhe do të ishte tregues i çështjeve kritike me të cilat duhet marrë. Në mënyrë që ta arrihet kjo, mund të identifikohen katër kategori mundësish për zgjedhjen e të intervistuarve. Këto duhet të kombinohen për një efektshmëri më të madhe:

1. Përzgjedhja ad hoc (rast pas rasti)
2. Përzgjedhja e çështjeve kritike
3. Përzgjedhja e përfaqësuesit
4. Përzgjedhja e të gjithëve ose asnjë

## **PËRZGJEDHJA AD HOC**

### **Përzgjedhja Spontane**

Skuadra mund t'i përzgjedhë spontanisht personat për intervistim gjatë kohës së një vizite, bazuar në hamendësime apo vëzhgime. Nëse ndonje prej individëve në fjalë do të refuzojë, kjo përzgjedhje e tyre do të respektohet. Megjithatë, monitoruesit do të jenë në gjendje të vlerësojnë arsyet e mundshme të refuzimit dhe të reagojnë si duhet pa e vënë

personin në rrezik. Përzgjedhja spontane ka disavantzhin se autoritetet, personeli apo të paraburgosurit e tjerë mund të mendojnë se personi i përzgjedhur është zgjedhur për një arsye të veçantë. Kjo gjë mund të shtonte mundësinë për ndëshkim. Për rrjedhojë, ka më pak risqe kur monitoruesit nuk janë të shoqëruar nga autoritetet gjatë turit të tyre nëpër vendqëndrime. Kjo metodë e vetme, nuk i siguron monitoruesve një model përfaqësimi për perspektivën.

### ***Vullnetarët***

Gjatë vizitës, individë apo grupe të paraburgosurish mund të kërkojnë të intervishen. Kjo nuk garanton një model përfaqësimi por mund të sigurojë një informacion të dobishëm që një përzgjedhje e planifikuar më parë nuk do ta siguronte. Koha për intervistimin e të paraburgosurve që kërkojnë bashkëbisedim privat duhet të futet në planin e vizitës por monitoruesit nuk duhet të varen vetëm nga të intervistuarit vullnetarë.

### ***Të Intervistuarit që Propozohen nga Autoritetet***

Gjatë një vizite, autoritetet mund të sugjerojnë që monitoruesit të intervistojnë të paraburgosur të caktuar. Në përgjithësi, këto intervista duhet të pranohen por duhet të menaxhohen në mënyrë të tillë që ato të mos e devijojnë skuadrën nga strategjia e saj intervistuese. Nëse pranimi i këtyre intervistave nuk është i dëshirueshëm, ata duhet me mirësjellje të mos i pranojnë duke theksuar se kërkesat e skuadrës së monitorimit janë të vendosura në një axhendë.

## **PËRZGJEDHJA E ÇËSHTJEVE KRITIKE**

### ***Para-Identifikimi i individëve të interesuar***

Grupi monitorues mund të ketë marrë informacion apo mund të ketë qenë i informuar për prezencën e individëve të veçantë vulnerabël apo për incidente specifike që pretendohet të kenë dhunuar të drejta e njeriut brenda vendit të paraburgimit në fjalë dhe ndofta mund të ketë dëshirë të kryej intervistime mbi këtë bazë. Kur grupet monitoruese dëshirojnë të intervistojnë individë të identifikuar më parë, monitoruesit duhet të intervistojnë edhe të paraburgosur të tjerë më përpara apo më pas, për një periudhë kohore të njëjtë. Duhet gjithashtu të mbahet në mend se, për monitoruesit parandalues qëllimi i mbledhjes së informacionit mbi incidentet specifike është të arrihet kuptueshmëria e problemeve sistematike. Kanalizimi i ankesave individuale drejt qëllimit për këshillim ligjor, çështje gjyqësore apo denoncim duhet qartësisht të diferencohet nga veprimtaria e monitorimit parandalues.

### ***Të Dhënat nga Regjistrat apo Dokumentat***

Me ekzaminimin e regjistrave dhe dokumentave të tjerë administrative gjatë vizitës monitoruese, skuadra monitoruese mund të ndeshet me anomali apo shqetësime që është e nevojshme të ndiqen nga intervistat private. Të paraburgosurit në fjalë do të jenë një burim esencial informacioni.

### ***Intervistimi Retrospektiv***

Monitoruesit mund të zgjedhin të intervistojnë persona që janë liruar ose transferuar nga një vend i caktuar paraburgimi, për eksperiencat e tyre. Këta persona shpesh janë më të çiltër kur nuk ndodhen më në ambientet e paraburgimit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për qendrat e paraburgimit ku personat e privuar nga liria e tyre qëndrojnë për një periudhë kohore relativisht të shkurtër apo kur intervistimi në vend mund të mos jetë i mundur. Monitoruesit duhet të kenë gjithashtu parasysh se automjetet transferuese janë vende paraburgimi ku mund të ndodhin abuzime. Intervistat duhet gjithashtu të përpiqen të mbulojnë edhe eksperiencat atje.

## **PËRZGJEDHJA E PËRFAQËSUESVE**

### ***Model i Rastësishëm***

Për një monitorim parandalues efektiv, strategjitë e sipër përmendura të përzgjedhura duhet t'i shtohen metodologjisë që është planifikuar të japë një model përfaqësimi të perspektivës së personave të privuar nga liria e tyre. Një model "i rastësishëm" mund të zgjidhet përshembull duke përzgjedhur personin e dytë apo dy të parët në çdo listë emërore të ndarë sipas alfabetit të mbiemrave të të paraburgosurve, nëse ka një listim të tillë alfabetik (A,B,C, etj.) apo thjesht dhjetë personat e parë të listës. Formula e saktë e përdorur do të varet nga numri i të paraburgosurve që ndodhen prezent dhe se sa intervista synon grupi monitorues të kryejë. Kjo metodologji duhet të modifikohet që të mund të merret me shtrirjen aktuale të vendqëndrimit dhe të faktorëve të tjerë, dhe ka disavantazhin se ajo normalisht kërkon që autoritetet të informohen se kë dëshiron skuadra të intervistojë.

### ***Model i Rastësishëm i Rafinuar***

Një version më i sofistikuar i të njejtit sistem që ndihmon për një model më shumë përfaqësues, megjithëse kërkon më shumë përgatitje, është identifikimi në regjistrat e të paraburgosurve i emrave të atyre që i përkasin kategorive strategjike në interes të skuadrës monitoruese. Shëmbuj të këtij lloj grupimi përfshijnë mes të tjerëve: të dënuarit me burgim të përjetshëm, të burgosurit e rinj, persona të vjetër në moshë, të burgosurit politik, të sapo mbërriturit, anëtarë të grupeve minoritare dhe të atyre të burgosur për krime serioze si terrorizmi. Pas identifikimit të natyrës së këtyre grupeve, skuadra monitoruese mund të vendosë për numrin apo përqindjen e atyre që do të intervistohen dhe zgjedhë ata që do të intervistojë bazuar në versionin e modifikuar të metodës së mësipërme të modelit rastësor. Kjo metodë seleksionimi është gjithashtu e dobishme për zgjedhjen e kandidatëve për intervistimet fillestare në grup.

Sikurse është vënë re, të gjitha këto metodologji duhet të kombinohen me qëllim që të kontribuohet drejt efektivitetit të intervistave monitoruese parandaluese.

## **PËRZGJEDHJA E TË GJITHËVE OSE ASNJË**

Lidhur me vendet e paraburgimit që mbajnë një numër të limituar personash siç janë komisaritet e vegjël të policisë, është e rëndësishme që monitoruesit të zgjedhin të intervistojnë ose të gjithë personat e privuar nga liria e tyre ose asnjë. Ata duhet ta shmangin intervistimin vetëm të disave, pasi risku për ndëshkim mund të jetë më i madh për ata të përzgjedhurit. Ata duhet gjithashtu të kenë parasysh se ndëshkimet kolektive nuk janë të padëguara. Eksperienca e skuadrës me institucionin dhe autoritetet e tij, si dhe mundësia për ndjekje nëpërmjet vizitave të mëtejshme, do ta ndriçonte këtë vendim.

## **5. Vlerësimi Përfundimtar mbi Strategjinë e Intervistimit**

### ***Formal përkundrejt Informal***

Vlen të kujtojmë që intervistat nuk ka pse të jenë formale. Biseda të shkurtëra dhe bashkëbisedime të shkujdesura, të iniciuara nga monitoruesit apo personat në vendin e paraburgimit, mund të jenë thelbësore për të marrë informacionin. Skuadra monitoruese duhet të bëjë një përpjekje të vëmendëshme që të mund të arrijë dhe perceptojë mundësi të tilla ndërsa njëkohësisht të mund të garantojë sigurinë e vetë dhe të aktorëve të tjerë.

### ***Përkujdesje të Përgjithshme***

Veç kësaj, menjëherë pas marrjes së informacioneve të rëndësishme nga një intervistë private, skuadra monitoruese nuk duhet në asnjë mënyrë të manifestojë apo të nxjerrë faktet nëse nuk ka marrë leje nga i intervistuari dhe nëse nuk e konsideron strategjikisht

të favorshme. Gjuha e trupit mund të tregojë më shumë në mënyrë të pandërgjegjshme dhe stafi institucional shpesh studjon sjelljen, përfshirë shenjat joverbale, të skuadrës monitoruese gjatë gjithë kohës së vizitës si dhe pas largimit të tyre.

Për më tepër, kur merret një informacion i rëndësishëm, është e rëndësishme, kurdoherë që është e mundur dhe me kujdesin e duhur, të konfirmohet informacioni në mënyrë të kujdesshme në intervistimet e tjera. Fakti i marrjes së të njejtit informacion nga disa burime i ofron një mbrojtje të caktuar burimit fillestar, megjithëse mundësia për ndëshkime të gabuara apo ndëshkime kolektive nuk mundet asnjëherë të skarcohet.

### **Raprezaliet**

Është e rëndësishme të theksohet nevoja për të integruar një strategji të përgjithshme për të parandaluar ndëshkimet dhe për të minimizuar rezikun që i kanoset të paraburgosurve- apo të tjerëve- që marrin pjesë në intervistimet monitoruese. Këto raprezalie ndodhin në të gjithë botën sidomos në qendrat e paraburgimit që tashmë prezantojnë situata shqetësuese të të drejtave të njeriut. Skuadra monitoruese duhet të respektojë parimin *mos dëmto* si përpara ashtu edhe gjatë apo pas vizitës. Siç është thënë, metodologjia e "para-vizitës" (si më lartë) jep një mundësi për të bërë vlerësimin e rreziqeve dhe për të adoptuar një strategji për t'ju adresuar këtyre rreziqeve edhe përpara vizitës. Një skuadër monitoruese e përgjegjshme mund të jetë e detyruar të marrë vendim të mos bëjë asnjë intervistim në rrethana që sugjestionojnë rreziqe të papranueshme dhe të pakontrollueshme.

Është gjithashtu thelbësore që skuadra monitoruese të garantojë në një shkallë të gjërë mundësinë se rreziqet ashtu si dhe çështjet e miratuara dhe konfidencialiteti janë kuptuar nga të intervistuarit potencial në të gjitha stadet e intervistës. Të intervistuarit duhet specifikisht të pyeten nëse kanë ndonjë arsye që ata preferojnë më mirë të mos intervistohen. Në këtë mënyrë ata mund të marrin vendimin më të mirë të mundshëm për vehten e tyre lidhur me bashkëpunimin me monitoruesit.

## **6. Konkluzioni**

Monitorimi parandalues në vendet e paraburgimit I kërkon monitoruesve të shqyrtojnë imtësisht kur vendosin se cilin person të privuar nga liria do të intervistojnë. Kjo ndihmon në efektivitetin maksimal të monitorimit në kontekstin e burimeve të limituara njerëzore, financiare, të përkohshme. Pasja e një strategjie seleksionimi i jep mundësi monitoruesve të depërtojnë sa të munden në situatën e përgjithshme si dhe në situatën e grupeve vulnerabël. Kombinimi i metodologjisë dhënë më sipër, do të kontribuonte në arritjen e këtyre qëllimeve.

Si gjithmonë, sa më e lartë të jetë cilësia e informacionit të mbledhur gjatë vizitës monitoruese, aq më të mira do të jenë analizat dhe propozimet sistematike që mund të bëhen. Kjo do të ndihmonte në detyrën themelore për t'i mundësuar personave të privuar nga liria aksesin dhe ushtrimin e të drejtave të tyre, do të parandalonte torturën dhe keqtrajtimet e jera dhe në përgjithësi do të forconte respektimin e të drejtave të njeriut në paraburgim.

